



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:153022

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06596924

K.DH.Shk II.nr.1517/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova në çështjen përmbartimore të kreditorit “Natural BI” SH.P.K., me numër unik identifikues 811357989 me seli në Ferizaj, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara me seli në Ferizaj, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1074/23 të datës 24.05.2024, me datë 13.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht ankesa e debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara me seli në Ferizaj, NDYSHOHET pika II e aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkalles se Pare - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1074/23 të datës 24.05.2024, ashtu që për këtë pikë të aktvendimit gjykohet si në vijim:

1.1 SHFUQIZOHET Urdhri për përmbartim P.nr.379/23 i datës 23.06.2023 i Përmbartuesit Privat Besnik H.Aliu, sa i përket faturës 26/2023 e datës 26.05.2023 në shumë prej 193,00 €, ndërsa

1.2 MBETET NË FUQI Urdhri për përmbartim P.nr.379/23 i datës 23.06.2023 i Përmbartuesit Privat Besnik H.Aliu, sa i përket faturës 44/2021 e datës 22.07.2021 në shumë prej 142,00€.

II. Pika I dhe III e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkalles se Pare- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1074/23 të datës 24.05.2024 mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata e Shkallës së Parë me aktvendimin KPPP.nr.1074/23 të datës 24.05.2024, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara, ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.379/23 i lejuar me datë 23.06.2023 nga

Përmbaruesi Privat Besnik H. Aliu sa i përket Faturës 14/2023 të datës 24.04.2023 në shumë prej 44.30€, Faturës 32/2023 të datës 05.06.2023 në shumë prej 67.50€ dhe Faturës 94/2022 të datës 28.12.2022 në shumë prej 246.00€. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi Urdhrit Përmbarimor P.nr.379/23 i lejuar me datë 23.06.2023 nga Përmbaruesi Privat Besnik H. Aliu sa i përket Faturës 26/2023 të datës 26.05.2023 në shumë prej 193.00€ dhe Faturës 44/2021 të datës 22.07.2021 në shumë prej 142.00€. Ndërsa në pikën III të dispozitivit është përfunduar procedura përmbarimore e iniciuar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.379/23 i lejuar me datë 23.06.2023 sa i përket Faturës 25/2023 në shumën prej 492.00 €, Faturës 19/2023 në shumën prej 40,10 € dhe Faturës nr.27/2023 në shumën prej 132.00€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, Besnik H. Aliu duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit “Natural BI” SH.P.K., mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës 27/2023 e datës 29.05.2023, 26/2023 e datës 26.05.2023, 25/2023 e datës 24.05.2023, 19/2023 e datës 15.05.2023, 14/2023 e datës 24.04.2023, 32/2023 e datës 05.06.2023, 94/2022 e datës 28.12.2022 dhe 44/2021 e datës 22.07.2021, me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,356.90€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Debitori, ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anulohet në tërësi urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Besnik H. Aliu, me numër , P.nr.379/23, të datës 23.06.2023. Kreditori në përgjigje në prapësim i kundërshton në tërësi thëniet e debitorit si të pabazuara, me arsyetimin se debitori nuk ka arritur që me asnjë provë materiale së paku ti vërteton të njëjtat, dhe qëllimi i tij është vonesa dhe shtyrja e përmbarimit.

Gjykata e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1074/23 të datës 24.05.2024, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se fatura 14/2023 e datës 24.04.2023 në shumë prej 44.30€, fatura 32/2023 e datës 05.06.2023 në shumë prej 67.50€ dhe fatura 94/2022 e datës

28.12.2022 në shumë prej 246.00€, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që të njëjtat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtat nuk kanë vulë apo nënshkrim të pranimit nga debitori. Ndërsa sa i përket faturës nr.26/2023 e datës 26.05.2023 në shumë prej 193.00€ dhe fatura 44/2021 e datës 22.07.2021 në shumë prej 142.00€, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit sa i përket pikës I dhe III të dispozitivit.

Ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara fatura 14/2023 e datës 24.04.2023 në shumë prej 44.30€, fatura 32/2023 e datës 05.06.2023 në shumë prej 67.50€ dhe fatura 94/2022 e datës 28.12.2022 në shumë prej 246.00€, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që të njëjtat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtat nuk kanë vulë apo nënshkrim të pranimit nga debitori. Ndërsa, fatura nr.26/2023 e datës 26.05.2023 në shumë prej 193.00€ dhe fatura 44/2021 e datës 22.07.2021 në shumë prej 142.00€, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me faturat 26/23 dt.26.05.2023 në shumë prej 193€ dhe faturës 44/2021 dt.22.07.2021 Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorit me ankesë dhe gjeti se ankesa për këto fatura është pjesërisht e bazuar dhe atë: Sa i

përket faturës 26/23 dt.26.05.2023 në shumë prej 193€ me ankesë u dëshmuar se debitori ka paguar këtë faturë ndërkaq faturën tjetër 44/2021 dt.22.07.2021, kjo Gjykatë vlerëson se nuk ka bazë ankimore që të pranohet ankesa e debitorit ngase për gjykatën fatura paraqet dokument të besueshëm pavarësisht rrethanave të COVID apo mbylljes së vitit fiskal 2021. Nga të lartcekurat kjo Gjykatë vlerësoi se në këtë pjesë ankesa duhet aprovuar dhe të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv.

Lidhur me pikan I dhe III të dispozitivit aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.DH.Shk II.nr.1517/24, me datë: 13.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova